



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-3804/1 datë 08.10.2021, NDËRPRITET  
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Lënda me numër 12-3804 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-3804/1 të datës 08.10.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për sjellje të pakujdesshme dhe keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar të zyrtarëve në ///, si dhe në lidhje me lejen e ndërtimit nr. /// të vitit ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar edhe një dëshmi - ekstrakt nga plani nr. /// të vitit /// .

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja kërkoi të dhëna, informacione dhe dokumentacion nga Komuna e /// për rastin konkret dhe pas këqyrjes së lëndës së dorëzuar vlerësoi se pretendimet e paraqitura në denoncim janë të pabazuara. Konkretisht, kundër miratimit të objektit të lartpërmendur është bërë ankesë në kohë, i cili me Aktvendimin /// nr. /// të vitit /// organi dytësorë kompetent – Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të RMV-së, ishte refuzuar si e pabazuar. Kundër vendimit dytësor nuk është ngritur asnjë mosmarrëveshje administrative, nga ku rezulton se kjo procedurë administrative pas dhënies së lejes së lartpërmendur të ndërtimit ka përfunduar përfundimisht dhe ligjërisht.

Bazuar në të gjeturat, KSHPK-ja konstaton se pretendimet e paraqitura në denoncim janë të pabazuara dhe se organi tjetër kompetent ka vepruar sipas pretendimeve nga denoncimi i parashtruesit , si rezultat i të cilit kanë humbur të gjitha bazat për veprime të mëtutjeshme të saj në rastin në fjalë.



Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

